



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:208661

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876298

KPPP.nr.1574/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo” SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “Robert Doll” nr.99, kundër debitorëve 1. “Xhaviti Beton Plus” SH.P.K., me NUI:811386392, me seli në Pejë, rruga “Bekim Berisha”, 2. G.G., me numër personal identifikues ..., me adresë në Pejë, fshati ..., 3. A.K. me numër personal identifikues ..., me adresë në Pejë, fshati ..., 4. K.K. me numër personal identifikues ..., me adresë në Pejë, fshati ..., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.282/2023 të datës 05.09.2023, të Përmbartuesit Privat Fatos Shatri, me seli në Pejë, jashtë seancës me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorëve 1. “Xhaviti Beton Plus” SH.P.K., 2. G.G., 3. A.K., 4.K.K. dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.282/2023 i datës 05.09.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fatos Shatri, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.282/2023 të datës 05.09.2023, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor – Marrëveshjen mbi pengun e datës 29.12.2021, me të cilin ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit në emër të masës ndëshkimore shumë në vlerë prej 26,971.12 €, si dhe kamata e rregullt dhe kamatëvonesën që do të arrij deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, në të kundërtën përmbartimi të realizohet përmes ndalimit të mjeteve në para të cilat i ka debitori në

llogaritë bankare, si dhe me sekuestrimin e kolateralit dhe i njëjti t'i dorëzohet kreditorit, me shitjen e tij të realizoj kërkesën e tij ndaj debitorit.

Debitorët në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, kanë deklaruar se urdhri përmbarimor i lejuar nga përmbaruesi privat nuk është i bazuar dhe nuk është i mbështetur në prova. Tutje kanë theksuar se urdhri përmbarim është marr në kundërshtim me nenin 71 paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.4 të LPP-së, dokumenti i besueshëm Marrëveshja mbi kredinë Nr.200732012 dhe Nr.200732044 e datës 29.12.2021, nuk është në origjinal, po ashtu ka shtuar se ka qenë e panevojshme fillimi i procedurës përmbarimore pasi që debitori do të vazhdoj në mënyrë të rregullt pagesat mujore në shumë prej 951.00 €. Gjykatës i ka propozuar që të shfuqizohet urdhri përmbarimor, si dhe të detyrohet kreditori që t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën prej 676.00 €.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, duke theksuar se prapësimi i debitorit nuk është i mbështetur në prova ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të LPP-së. Tutje ka shtuar se propozimi për përmbarim i kreditorit i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara me nenin 38 paragrafi 1 të LPP-së, debitorët janë në vonesë në kthimin e detyrimeve ndaj kreditori, të njëjtit janë njoftuar për fillimin e procedurës përmbarimore, po ashtu ka shtuar se prapësimi i debitorit është ushtruar jashtë afatit pasi që të njëjtit urdhrin përmbarimor e kanë pranuar me datë 14.09.2023, ndërsa prapësimin sipas vulës së protokollit të përmbaruesit privat e kanë ushtruar me datë 25.09.2023. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorëve ta hedh poshtë si të pa afatshëm, ose ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. ndërsa me nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për

Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: “...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”. Në anën tjetër, me nenin 27, paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: “Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Marrëveshja mbi Pengun e datës 29.12.2021, në bazë të së cilit është mbështetur propozimi për përmbartim është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se: “Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: “...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim nga përmbartuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.

Andaj nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbartimit P.nr.282/2023 i datës 05.09.2023, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbartim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit përmbartimor dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.

Gjykata mori parasysh se dokumenti përmbartimor, përkatësisht Marrëveshjet e pengut mbi bazë e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor mban vulën e saktësisë së lëshuar nga ana e

kreditorit, mirëpo gjeti se vendosja e vulës së tillë nga ana e kreditorit, të njëjtit dokument nuk i jep tiparet e dokumentit të vërtetuar nga origjinali, ngase për vërtetësinë e kopjes nga origjinale kompetent është organi noterial dhe atë në kuptim të nenit 47 paragrafi 1 të Ligjit për noterinë.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarrim, ndërsa organi përmbarrues - përmbarruesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprjë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbarrimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në kuptim të nenit 43, 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1574/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.